

BULETIN

Preportr



2017



MËSYMJA E MADHE

BESA KALAJA

Një pjesë e konsiderueshme e profesorëve universitar mbajnë njëkohësisht edhe poste të larta shtetërore dhe politike në vend. Disa prej tyre madje edhe postet më të larta si atë të presidentit dhe të kryeministrit. Kjo në masë të madhe e ka dëmtuar arsimin e lartë në Kosovë sidomos universitetin më të madh në vend, atë të Prishtinës, ku për pasojë e ka zhveshur nga çdo cilësi akademike dhe ia ka humbur çdo integritet stafit të tij akademik

Dështimi i Universitetit të Prishtinës për të shërbyer si një qendër e ngritjes së njëmend të dijes, lidhet drejtpërdrejt me ndikimin që partitë politike kanë pasur në të.

Në mes tjerash, partitë politike shfrytëzuan emërimet e profesorëve si bartës të funksioneve politike për të shtrirë ndikimin e tyre në ambientet ku flitet për dijen dhe ku rëndom politika nuk do të duhej të ketë hapësirë

të shtrihet, ashtu siç ndodhë në Kosovë

Fatkeqësisht, formula e politikanëve mbi profesorët funksioni. Aty ku s' duhej të zinte vend politika, u arrit kulmi i politizimit. Universiteti i Prishtinës tashmë i zhveshur nga cilësitë akademike dhe kërkimore, u bë qendër e debateve politike, ku për vite më radhë politika u shtri në vendimarrjen e universitetit, në përzgjedhjen e stafit akademik, rektorëve, studentëve, madje edhe në përzgjedhjen e administratës.

Ky hulimtim si dhe hulimtime të kësaj natyre që janë bërë në të kaluarën nga Preportr, mbi UP-në kanë gjetur se si shumë profesorë të Universitetit të Prishtinës, janë pjesë e politikës, madje shumë prej tyre ushtrojnë apo kanë ushtruar funksionet më të larta shtetërore e parti-ake. Pak iniciativa që janë ndërmarrë për ta mbrojtur UP-në nga politika janë shuar që në fillim. Gjendja ka vazhduar e njëjtë. Politika ka dërguar njerëzit e saj në detyra kyçe në universitet.

Një mënyrë e tillë e funksionimit të universitetit për ekspertizë e arsimit është vlerësuar të jetë mjaft shqetësuese.

“Një institucion publik i arsimit të lartë duhet të garantojë ruajtjen e vendit të punës për stafin akademik që emërohet ose zgjedhet në disa poste të larta shtetërore, si: ministër, deputet, ambasador e të ngjashme. Megjithatë, universiteti nuk është i detyruar që të emëruarit t’i angazhojë në procesin mësimor gjatë periudhës sa zgjat emërimi i tyre, pikërisht për shkak të pamundësisë për t’i kryer me përpikëri detyrat e punës”, thotë Dukagjin Pupovci, njohës i fushës së arsimit.

Në realitet ndodhë e kundërta. Shumica e këtyre njerëzve, jo që angazhohen me orar të plotë në UP, por këtë angazhim e zgjerojnë edhe në kolegje private.

Vet fakti se dikush është anëtar i një partie politike, sipas Pupovcit nuk do të duhej të ishte pengesë për angazhim në jetën akademike, me kusht që rreshtimi politik të mos ndikojë në kryerjen e detyrave akademike.

Ai mendon që zgjidhja e vetme është që kjo çështje të rregullohet me ligj, duke kufizuar mundësinë që bartësit e funksioneve të larta publike të marrin angazhime shtesë jashtë detyrës që ushtrojnë.

Natyrisht, s’duhet lënë pa përmendur një numër të konsiderueshëm të profesorëve që megjithatë edhe sot e kësaj dite vazhdojnë t’i rezistojnë politikës dhe përmeshin detyrat që i kanë marrë përsipër.

GJURMËVE TË POLITIZIMIT

Ky shkrim analitik është i bazuar në një hulimtim të thellë të Preportr, mbi strukturën dhe lidhjen e profe-

sorëve të Universitetit të Prishtinës me politikën, me mostra nga katër fakultete, përkatësisht atë Filozofik, Ekonomik, Juridik dhe të Mjekësisë. Hulimtimi ka pasur për qëllim të analizojë patronazhin politik dhe të sjellë në pah shkallën e shtrirjes së politikës në UP përmes vetë akterëve kryesor të universitetit- profesorëve universitar.

Për një periudhë prej më shumë se tre muajsh, ekipi hulimtuës ka gjurmuar dhe konfirmuar të dhëna për 374 profesorë që kanë qenë subjekt i hulimitit në këtë agjendë, të cilët gjenden në ueb-faqet e këtyre katër fakulteteve dhe ka dalë që 50 prej tyre figurojnë të kenë qenë apo vazhdojnë të jenë edhe sot akterë politik që politikën e kanë pasur aktivitet primar ndonëse kanë çelikorur pozitat e profesorëve.

Disa prej tyre kanë mbajtur pozitat më të larta shtetërore në vend siç ishte rasti me presidentin Fatmir Sejdiu, profesor në Fakultetin Juridik apo me ish -kryeministrin, Isa Mustafa që është edhe profesor në Fakultetin Ekonomik.

Të gjeturat e Preportr përveç se kanë evidentuar këto 50 raste kur profesorët universitar kanë qenë pjesëmarrës në politikë dhe në institucionet më të larta të vendit, po ashtu tregojnë se politika edhe sot e kësaj dite perceptohet nga profesorët si mundësia e artë për të avancuar karrierën e tyre.

Po ashtu, të dhënat dhe interpretimi i tyre i paanshëm, sugjerojnë se politika është aq e shtrirë në UP sa që vetë zgjedhja e organeve udhëheqëse të universitetit nuk mund të bëhet pa një përkatësi apo përkrahje politike, ku primatin në këtë rrafsh e mbajnë Partia Demokratike e Kosovës, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe nga partitë tjera kudo që iu ka dhënë rasti. E kujtojmë këtu rastin e fundit të zgjedhjes së rektorit Marjan Dema. Ai ka qenë në listën e PDK-së për deputet të Kuvendit të Kosovës.

Preportr në vitin 2013, ka realizuar një hulimtim tjetër të cilin e ka shtrirë në tërë Universitetin e Prishtinës për të parë jo vetëm si bëhet përzgjedhja e stafit dhe organeve udhëheqëse, por edhe sa poste tjera politike dhe publike mbajnë profesorët e këtij Universiteti por edhe profesorët që punojnë në kolegje private. Nga ky hulimtim ka dalë që 102 zyrtarë që kanë poste politike dhe që mbajnë pozita të larta publike punojnë në UP dhe kolegje private.



Fakulteti	Departamenti	Emri	Funksioni	Partia politike	Pershkrimi i lidhjes
Fakulteti Juridik		Arsim Bajrami	Profesor i rregullt	PDK	Ministër i Arsimit 2014-2017
Fakulteti Juridik		Beqir Sadikaj	Profesor i rregullt	PDK	Kandidat për deputet të PDK me 2014
Fakulteti Juridik		Nerxhivane Dauti	Profesor i rregullt	PDK	Kandidate për deputete të PDK me 2014. Deputete në tri mandate 2001-2010 nga PDK
Fakulteti Juridik		Haki Demolli	Profesor i rregullt	LDK	Ish-deputet i LDK dhe ish-ministër i MFSK gjatë viteve 2014-2017
Fakulteti Juridik		Fatmir Sejdiu	Profesor i rregullt	LDK	Ish-kryetar i LDK-së, president i vendit
Fakulteti Juridik		Hajredin Kuçi	Profesor i rregullt	PDK	ish-zëvendëskryeministër nga radhët e PDK
Fakulteti Juridik		Azem Hajdari	Profesor i asocuar	LDK	Ishte kandidat i LDK për deputet me 2010. Është larguar nga kjo parti me 2014
Fakulteti Juridik		Nuri Bexheti	Profesor i asocuar	PDK	Ish-këshilltar politik i ministrit Ramë Buja
Fakulteti Juridik		Besfort Rrecaj	Profesor asistent	PDK	Ish-këshilltar politik i ministres Vlora Çitaku në Ministrinë e Integrimi me 2011-2013
Fakulteti Juridik		Vjosa Osmani	Asistente	LDK	Deputete e Kuvendit të Kosovës në tri mandate nga viti 2010 nga LDK
Fakulteti Juridik		Xhafer Tahiri	Asistent	LDK	Ish-deputet i Kuvendit të Kosovës nga LDK, kandidat për kryetar komune në KK Vushtrri
Fakulteti Ekonomik		Isa Mustafa	Profesor i rregullt	LDK	Kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës- ish kryeministër i vendit
Fakulteti Ekonomik		Skender Ahmeti	Profesor i rregullt	PDK	Këshilltar politik i ish ministres Justina Shiroka-Pula
Fakulteti Ekonomik		Justina Pula	Profesor i rregullt	PDK	Ish ministre dhe deputete nga radhët e PDK-së
Fakulteti Ekonomik		Berim Ramosaj	Profesor i rregullt	LDK	Ish deputet i LDD. Më 2009 kaloi në LDK
Fakulteti Ekonomik		Myrvete Badivuku-Pantina	Profesor i rregullt	LDK	Deputete e Kuvendit të Kosovës 2007-2010 nga LDK
Fakulteti Ekonomik		Safet Merovci	Profesor i asocuar	PDK	Ish-këshilltar i kryeministrit Bajram Rexhepit (2002-2004). Ish-anëtar i Këshillit Drejtues të PDK-së. Zv. Minister i financave në qeverinë e përkohshme 1999-2000
Fakulteti Ekonomik		Afërdita Berisha-Shaqiri	Profesor i asocuar	LDK	Deputete e Kuvendit të Kosovës 2011-2014
Fakulteti Ekonomik		Drita Konxheli-Radoniqi	Profesor i asocuar	LDK	Kandidate për deputete me 2011 nga LDK
Fakulteti Ekonomik		Mazllum Baraliu	Profesor i asocuar	VV	Kandidat i VV për deputet me 2014
Fakulteti Ekonomik		Besnik Krasniqi	Profesor i asocuar	LDK	Kandidat për deputet i LDK më 2017
Fakulteti Ekonomik		Besim Beqaj	Profesor i asocuar	PDK	Deputet i Kuvendit të Kosovës 2014-2017
Fakulteti Ekonomik		Driton Qehaja	Profesor i asocuar	PDK	Këshilltar politik për çështje ekonomike i ish-kryeministrit Hashim Thaçi
Fakulteti Ekonomik		Avdullah Hoti	Profesor i asocuar	LDK	Ish-ministër i financave në Qeverinë Mustafa, deputet nga viti 2017
Fakulteti Ekonomik		Armand Krasniqi	Profesor i asocuar	PDK	Këshilltar politik i ish-zëvendëskryeministrit Hajredin Kuçi 2008-2010
Fakulteti Ekonomik		Petrit Gashi	Profesor i asocuar	LDK	Këshilltar i ish ministrit Lutfi Zharku me 2009, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë

Fakulteti	Departamenti	Emri	Funksioni	Partia politike	Pershkrimi i lidhjes
Fakulteti Ekonomik		Hykmete Bajrami	Profesor asistent	LDK	Ish-ministre e Tregtisë dhe Industrisë 2014-2017. Deputete nga radhët e LDK 2010-2017
Fakulteti Ekonomik		Mrika Kotorri	Profesor asistent	PDK	Këshilltare politike e ish-kryeministrit Hashim Thaçi 2011
Fakulteti Ekonomik		Sevdie Alshiqi	Asistente	LDK	Kandidate për deputete më 2010 nga LDK
Fakulteti Filozofik	Departamenti i Sociologjisë	Agim Hyseni	Profesor	PDK	Zëvendësministër i Arsimit 2008-2011 nga PDK
Fakulteti Filozofik	Departamenti i Sociologjisë	Anton Berishaj	Profesor	ORA	Ishte kandidat për deputet i Partisë Reformiste ORA me 2007
Fakulteti Filozofik	Departamenti i Shkencave Politike	Agim Zogaj	Profesor	PDK	Anëtar i PDK
Fakulteti Filozofik	Departamenti i Shkencave Politike	Enver Hoxhaj	Profesor	PDK	Ministër në dy ministri gjatë viteve 2007-2017 dhe deputet i PDK në mandatin 2017-2021
Fakulteti Filozofik	Departamenti i Sociologjisë	Ibrahim Berisha	Profesor	LDK	Këshilltar i ish presidentit Fatmir Sejdiu dhe njëri prej themeluesve të LDK
Fakulteti Filozofik	Departamenti i Historisë	Ibrahim Gashi	Profesor	PDK	Anëtar i PDK. Ka qenë nënkryetar i AKR dhe ka mbajtur disa pozita të rëndësishme politike, përfshirë edhe atë të deputetit
Fakulteti Filozofik	Departamenti i Shkencave Politike	Sejdi Rexhepi	Profesor	PDK	Ish-asamblist i KK të Prishtinës
Fakulteti Filozofik	Departamenti i Filozofisë	Astrit Salihu	Profesor	PDK	Ish-kandidat për kryetar të Prishtinës nga PDK me 2009. Këshilltar politik i presidentit Hashim Thaçi
Fakulteti Filozofik	Departamenti i Historisë	Bujar Dugolli	Profesor	PDK	Kandidat i PDK për deputet në zgjedhjet e vitit 2010. Para 2010 ishte në AAK dhe ka qenë deputet i këtij subjekti politik si dhe ministër i Tregtisë dhe Industrisë
Fakulteti Filozofik	Departamenti i Sociologjisë	Fadil Maloku	Profesor	AKR	Ishte përfaqësues i AKR në KQZ deri me 2013 vit kur e la këtë parti
Fakulteti Filozofik	Departamenti i Psikologjisë	Mytaher Haskuka	Profesor	VV	Deputet i Kuvendit të Kosovës në dy mandate 2014-2021 nga VV, dhe kandidat për kryetar të KK Prizren
Fakulteti Filozofik	Departamenti i Shkencave Politike	Afrim Hoti	Profesor	AKR	Kandidat për deputet nga radhët e AKR-së në vitin 2014. Ish-këshilltar politik i ministrit për Zhvillim Ekonomik Fadil Ismaili. Ka dhënë dorëheqje nga kjo parti në qershor të vitit 2015.
Fakulteti Filozofik	Departamenti i Filozofisë	Blerim Latifi	Asistent	PDK	Këshilltar i Kryetari të Kuvendit të Kosovës
Fakulteti Filozofik	Departamenti i Shkencave Politike	Zenun Halili	Profesor	PDK	Këshilltar i lartë politik i ministrit të Arsimit, Arsime Bajramit 2014-2017. Ishte në listën e AAK për deputet më 2014
Fakulteti i Mjekësisë		Salih Ahmeti	Profesor	PDK	Udhëheqës i Departamentit për Shëndetësi në Kabinetin për Qeverisje të mirë në PDK 2005-2007
Fakulteti i Mjekësisë		Hatixhe Latifi Pupovci	Profesor i asocuar	VV	Këshilltare komunale në KK të Prishtinës nga VV 2013-2017
Fakulteti i Mjekësisë		Mybera Ferizi	Profesor i asocuar	LDK	Kandidate për deputete e LDK me 2014
Fakulteti i Mjekësisë		Zylfije Hundozi	Profesor i asocuar	AAK	Disa mandate deputete e Kuvendit të Kosovës nga AAK
Fakulteti i Mjekësisë		Nehat Baftiu	Profesor asistent	PDK	Deputet i PDK në Kuvendin e Kosovës mandat të cilin e mori në fund të 2016
Fakulteti i Mjekësisë		Ramë Miftari	Profesor asistent	PDK	Anëtar i Këshillit Drejtues të degës së PDK në Prishtinë
Fakulteti i Mjekësisë		Albena Reshitaj	asistent	AKR	Nënpresidente e AKR

PUNËSIMI DHE AVANCIMI NË UP KALON PËRMES DYERVE TË PARTIVE POLITIKE

Në katër fakultetet që janë hulumtuar, Peportri ka gjetur të dhëna që flasin për një numër të madh të profesorëve të angazhuar në politikë ndër vite. Nga 54 profesorët që i ka Fakulteti Filozofik, 14 nga ta kanë bartur apo bartin funksione politike, ndër të cilët 9 janë nga PDK-ja, 2 nga AKR-ja, 1 nga LDK-ja, 1

Fakulteti Filozofik ka

9 1 2 1 1
PDK LDK AKR LVV ORA

Fakulteti Juridik ka

6 5
PDK LDK

Fakulteti Ekonomik ka

10 7 1
LDK PDK LVV

Fakultetin e Mjekësisë ka

3 1 1 1 1
PDK LDK AAK LVV AKR

nga Vetëvendosje!, dhe një nga ish Partia Reformiste ORA, megjithëse në zanatin e ri, atë të politikanëve, disa profesorë kanë ndërruar partitë politike më shumë sesa një herë.

Në Fakultetin Juridik, nga 71 profesorë që ka ky institucion, 11 prej tyre kanë qenë apo janë aktiv në politikë, të cilët politikisht janë të kësaj përbërje: 6 nga PDK-ja dhe 5 nga LDK-ja.

Në Fakultetin Ekonomik, nga gjithsej 66 profesorë që i ka i njëjti, figurojnë 18 profesorë që ndër vite zanatin primar e kanë pasur politikën. Nga ta, 10 vijnë nga LDK-ja, 7 nga PDK-ja, dhe një nga Vetëvendosje!

Në Fakultetin e Mjekësisë, gjendja qëndron ndryshe, nga 183 që janë gjithsej, 7 nga profesorët e këtij fakulteti kanë ndarë fatin e politikës me kolegët e lartshënuar. Nga ta, 3 vijnë nga PDK-ja, 1 nga LDK-ja, 1 nga AKR-ja, 1 nga AAK-ja dhe 1 nga Vetëvendosje! Asnjë prej këtyre profesorëve nuk kanë pozita shumë të larta në politikë.

Nga këto katër fakultete, janë hulumtuar gjithsej 374 profesorë, ndër të cilët 50 figurojnë se kanë pasur lidhje direkte me politikën apo shprehur në përqindje, 13.36% e tyre, përqindje kjo mjaft e lartë që tregon se nuk bëhet fjalë për ko incidencë, por ka politizim të thellë, veçmas kur ia shtojmë faktin se këto të dhëna janë vetëm për katër fakultete të UP-së.

Për nga aspekti i funksioneve që profesorët universitar kanë mbajtur apo mbajnë ndër vite, të dhënat flasin për ministra dhe ish-ministra, këshilltarë presidentësh, anëtarë partie, ish-ректорë, kandidatë për deputetë dhe deputetë, zëvendësministra, asamblistë komunal, kandidat për kryetar komune, presidentë dhe kryetar partie, kryeministër, këshilltarë politikë të ministrave, këshilltarë të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, nënkryetar partie etj.

Politizimi i Universitetit të Prishtinës sipas kësaj strukture të pozitave institucionale që kanë bartur profesorët që punojnë aty, siç mund të vërehet, ka pasur dimension të thellë. Por s' duhet harruar se politizimi është shfrytëzuar edhe për akomodimet brenda për brenda UP-së. Vetë i pari i Fakultetit Filozofik, përmes aktiviteteve të tij politike në kohën kur ende ishte student, për çfarë edhe kishte respekt, u katapultua nga politika fillimisht në zgjedhjen e tij si profesor e më tutje edhe zgjedhjen e tij si dekan të këtij institucioni, pozitë që vazhdon ta mbajë edhe sot në mandatin e tij të dytë. Si Dugolli janë edhe një varg profesorësh të tjerë të këtij fakulteti të cilët përfituan pozita publike dhe politike në nivele të ndryshme të qeverisjes. Shumica prej tyre edhe kur u emëruan në pozita të larta politike e shtetërore vazhduan pa asnjë problem punën në universitet.

Përveç profesorëve, edhe ish-udhëheqësit e dikurshëm të organizatave studentore përfituan nga politika. Disa prej tyre, sot janë profesorë universiteti e disa të tjerë bartin funksione ekzekutive në kompanitë publike anë e kënd bordeve të pavarura të Kosovës.

EFEKTI I MBRAPSHTË I DIJËS

Kosova është vend i vogël dhe arsimimi është parë shpeshherë si e vetmja rrugë që mund t'i sigurojë asaj një zhvillim ekonomik dhe shoqëror afatgjatë dhe të qëndrueshëm. Megjithatë, në këtë kuadër, cilësia e arsimit dhe veçmas atij të lartë, si duket nuk është duke dhënë asnjë efekt real.

Diplomat nuk janë më indikatorë të performancës dhe kompetencave të studentëve po aq sa edhe programet e studimit të cilat shpeshherë nuk akreditohej si pasojë e neglizhencës dhe papërgjegjshmërisë totale nga ana e stafit akademik të Universitetit. Profesorët e përfshirë në politikë megjithëse jo një zgjedhje e qëlluar, përveç përfitimeve të veta personale, nga pozitat institucionale nuk kanë ndikuar aspak për përmirësimin e cilësisë në universitet. Me dhjetëra departamente vazhdojnë të udhëhiqen nga profesorët me grada shkencore të pamjaftueshme.

Kushtet dhe rrethanat për punë kërkimore janë shpërfillur nga të gjitha qeveritë e pasluftës dhe kanë demotivuar edhe ata pak profesorë serioz që shkencën nuk e kanë rastësi. Mungesa e stafit të kualifikuar në UP, veçmas kur ia shtojmë faktin se ata që kanë kualifikimet e duhura janë akterë politik më shumë sesa profesorë universitar, e ka bërë universitetin një destinacion të 'paushall'. Përderisa në shoqëritë bashkëkohore më shumë sesa bartja e një titulli vlen kompetenca dhe profesionalizmi, në ambientin e Kosovës profesorët e angazhuar në politikë vazhdojnë ta dominojnë kursin e kualifikimeve të tyre si shtylla rreth së cilës duhet të sillet gjithçka, ani pse performancën e tyre s'kemi as se si ta masim. Për faktin se janë mbajtur të dy e më shumë pozitave publike njëherësh, vjen në pyetje edhe mënyra se si profesorët arrijnë të performojnë në kuadër të të gjitha këtyre pozitave. Përgjithësisht, puna akademike është disiplinë e veçantë dhe tërësisht e ndryshme me menaxhimin ditor të misionëve politike dhe ekzekutive.

Hulumtimet e viteve paraprake tregojnë se profesorët e angazhuar në politikë nuk i kanë mbajtur ligjëratat me rregull, ndërsa për kohën e konsultimeve as që diskutohet. Mosrespektimi i orarit të ligjëratave, të provimeve, konsultimeve, mosrespektimi i syllabuseve nga profesorët, mosimplementimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe vlerësimit, vlerësimi jo objektiv i studentëve nga profesorët, janë disa nga shkeljet e stafit akademik që përmenden në raportin e procesit të monitorimit të kryer në UP nga Parlamenti i Studentëve (PS) në vitin 2012. Një organizatë tjetër ORCA këtë vit ka monitoruar orarët e përcaktuara

” Interferimi i politikës në universitete është më i pranishëm në vendet totalitare dhe në tranzicion ”

Dukagjin Pupovci,
njohës i fushës së arsimit

për konsultime me studentë dhe ka parë se me shumë pak përjashtime, pjesa dërrmuese e profesorëve në fakultetet e monitoruara nuk u përmbahen këtyre orareve.

Në vendet e zhvilluar edhe pse është i pranishëm ndikimi i politikës ai nuk manifestohet si tek ne.

Pupovci thotë se interferimi i politikës në universitete është më i pranishëm në vendet totalitare dhe në tranzicion. “Në mesin e institucioneve që i ekspozohen interferimit politik ka edhe të tilla që janë në top 500, por ai lloj i interferimit politik është më i sofistikuar dhe nuk nënkupton akomodimin e personave që nuk kanë kualifikime akademike përkatëse në ato institucione, siç veprohet në masë të madhe tek ne”, thotë ai.

Pra, sipas tij është një nivel tjetër i interferimit politik që ka të bëjë me sigurimin e lojalitetit ndaj pushtetit, por përmes njerëzve të kualifikuar dhe, jo medoemos, keqpërdorues. Ndërkaq, në ato vende ku politika interferon ashtu siç interferon tek ne, gjendja nuk është shumë më e mirë.

Interferimi tipik i politikës në Kosovë sipas Pupovcit manifestohet në formë të dhënies së gradës shkencore ose akademike ndonjë personi të afërt me politikën, i cili nuk i përmbushë as standardet minimale për një gradë të tillë, pastaj emërimi në poste të personave të afërt me politikën, që nuk punojnë për të mirën e institucionit, por të bosëve të tyre.

Kësisoj, realiteti aktual në rastin e profesorëve me poste publike dhe politike ka prodhuar dhe vazhdon të prodhojë figurën e profesorëve të shpërqendruar në njërin anë dhe menaxherëve të pa efikas në anën tjetër. Përderisa në vendet e zhvilluara formula prej 50 studentësh për një profesor, paraqet limitin pas së cilit shtrohet nevoja për një profesor të dytë, në rastin tonë ky argument pedagogjik nuk merret për konsideratë.

Preportr

BULETIN

Preportr - Qendra Kosovare për Gazetari Hulomtuese është një projekt i filluar nga Organizata anti-korrupsion në Kosovë - ÇOHU. Projekti ka për qëllim ngritjen dhe mbështetjen e gazetarisë hulomtuese në Kosovë përmes ofrimit të një hapësire alternative për gazetarët entuziastë që të transmetojnë hulomitimet e tyre pa frikën e cenzurës.

BULETINI REDAKTOHET NGA:

Arton Demhasaj

AUTORE:

Besa Kalaja

DESIGN AND LAYOUT:

envinion

TELEFONI:

038 248 506.

E-MAIL:

office@preportr.com.
preportr.cohu.org

Shënim: Organizata Çohu është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet - KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS

Ky hulomtim është pjesë e programit të KITU-së. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulomtim janë të Organizatës Çohu! dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS.



Organizata për
Demokraci, Antikorrupsion
dhe Dinjitet, Çohu!



KOALICIONI PËR INTEGRITET DHE
TRANSPARENCE NË UNIVERSITET



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society